



## AKT - THEMELIMI

### I SHOQERISE "HYDROPOWER" SHPK

Ne Tirane sot me date 03.06.2005 ,ne mbeshtetje te Ligjit 7638 dt. 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligji 7667 datë 28/01/1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare,

1.Lulzim Kapllanaj I biri I Isufit, lindur me 15.11.1984 ne Fier, banues ne Tirane, RR. Unaza e re, me pasaporte nr. 1897809 shtetas shqiptar, dhe

2.CHRISTIANA TSOUKATOS, lindur me 18,.12.1976 ne Athine, banuese ne Athine, me pasaporte greke nr. 735035, shtetase greke,  
deklarojne si me poshte:

#### Neni 1

Të themelojne shoqërine tregtare me përgjegjësi të kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike, te emërtuar "**HYDROPOWER** sh.p.k me ortake Z. Lulezim Kallanaj dhe z.Christiana Tsoukatos.

#### Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

#### Neni 3

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë,Rr. Unaza e Re.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi, përfaqësi, seli sekondare si dhe ti suprimojë ato, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### Neni 4

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me kufi të pacaktuar mbi 10 vjet.

Shoqeria mund të shpërbëhet në çdo kohë sipas rasteve te parashikuara ne statutin e kasaj shoqerie dhe legjislacionin shqiptar.

#### Neni 5

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë do të jetë 100.000 lekë, ne masen 50 % secili ortak themelues.

#### Neni 6

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- Import - eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve, me shumicë dhe pakicë si:
- Tregëtim artikuj të ndryshëm industriale.
- Tegtim automjetesh të çdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to.
- Tegtim karburante dhe vajrash lubrifikante me pakice.
- Tegtim artikuj të ndryshëm ushqimore.
- Transport mallrash të të gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit.
- Transport udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit.
- Tregëtimin e lëndëve të para gjysëm fabrikate.
- Tregëtimin e materialeve të ndërtimit, inerte etj.
- Hapje Hoteleri, kafe-bare, restorante, ushqim social, diskoteka, qëndra pushimi e kurative.

#### Neni 7

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Kodit të Punës, si dhe akteve të dala në zbatim të tij.

#### Neni 8

Shoqëria vepron në rregjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejat e detyrimet vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaket themelues mbartin rrezikun e veprimtarisë së Shoqërisë vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në shoqëri.

#### Neni 9

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë midis punonjësve brenda saj, si dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim mbeten në kopetencë të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku do të jetë dhe rregjistri tregtar i saj.

#### Neni 10

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërtimit.

#### Neni 11

Aktiviteti ekonomik dhe investimet e kesaj shoqërie mbrohen nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 12

**Administrator** i shoqërisë do të jetë **Z. Lulzim Kapllanaj**. Administratori ushtron dhe ndjek aktivitetin e shoqerise se krijuar prej ortakeve te mesiperm, duke zbatuar edhe kompetencat sipas dispozitave perkatese te statutit. Modalitetet për ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga statuti i shoqërisë dhe Ligji 7638 dt. 19/11/1992 "Për Shoqëritë tregtare".

Neni 13

Per ruajtjen dhe sigurimin e pasurive te luajtshme dhe ta paluajtshme kjo shoqeri mund ti drejtohet organizmave apo instituteve perkatese ne qender dhe ne deget e tyre.

Neni 14


Dispozita me te hollesishme jane parashtruar ne statutin e kesaj shoqerie e cila shpreh vullnetin e lire te themeluesve.


Ky akt themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

ORTAKET

LULZIM KAPLLANAJ

CHRISTIANA TSOUKATOS

  
Lulzim Kapllanaj

  
Christiana Tsoukatos

PERKTHYESI





## STATUTI

### I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "HYDROPOWER"

#### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

##### Neni 1

##### EMERTIMI - FORMA

Shoqëria me pergjegjesi te kufizuar "HYDROPOWER" sh.p.k themelohet ne perputhje me ligjin 7638 dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Kjo shoqeri krijohet nga ortaket:

1. Lulzim Kapllanaj, shtetas shqiptar dhe
2. Christiana Tsoukatos, shtetase greke

te cilet vendosin krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar " HYDROPOWER" sh.p.k

##### Neni 2

Shoqëria sh.p.k zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj (Akt- themelimi dhe Statuti).

Shoqeria " HYDROPOWER" sh.p.k eshte person juridik. Ajo e fiton kete te drejte si person juridik nga data e rregjistrimit te kesaj shoqerie ne rregjistrin tregtar te Gjykates se Shkalies se Pare Tirane.

##### Neni 3

##### OBJEKTI

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- Import - eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve, me shumicë dhe pakicë si:
- Tregëtim artikuj të ndryshëm industriale.
- Tegtim automjetesh të çdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to.
- Tegtim karburante dhe vajrash lubrifikante me pakice.
- Tegtim artikuj të ndryshëm ushqimore.
- Transport mallrash të të gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit.
- Transport udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit.

- Tregëtimin e lëndëve të para gjysëm fabrikate.
- Tregëtimin e materialve të ndërtimit, inerte etj.
- Hapje hotele, kafe- bare, restorante, ushqim social, diskoteka, qëndra pushimi e kurative.

#### Neni 4

##### SELIA

Shoqëria "HYDROPOWER" sh.p.k. e ka selinë e saj në Tiranë, **Rr. Unaza e re**.

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi, përfaqësi, seli sekondare si dhe ti suprimojë ato.

##### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqëria Tregtare Private "HYDROPOWER" do të ketë një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike me një kufi të pacaktuar e mbi 10 vjet dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë për çfarëdo shkaku sipas dispozitave qe percaktohen ne kete statut, me vendim te Asamblese se Ortakeve dhe sipas kritereve qe percaktohen ne legjislacionin ne fuqi.

#### Neni 6

##### KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestari i Shoqërisë, Eshtë 100.000 lekë, ne masen 50% secili ortak themelues.

Të gjitha pjesët e kapitalit të Shoqërisë janë te transferueshme ne perputhje me ligjin.

#### Neni 7

Shoqeria "HYDROPOWER"sh.p.k per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretet pergjigjet vetem me pasurite e saj. Ortaket e kesaj shoqerie nuk per gjigjen per detyrimet e kesaj shoqerie me pasurite e tyre qe nuk jane futur ne kapitalin e kesaj shoqerie. Pjesmarrja ne kete shoqeri nuk pengon ortaket te kene pavaresi ligjore, organizative dhe te drejta pronesie jashte kesaj shoqerie.

##### ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI NE SHOQERI

#### Neni 8

Organi me i larte vendimor I Shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve.

Ortaket kane te drejte te marrin pjesë personalisht apo duke autorizuar me shkrim një person tjeter duke mos qene ortak ne kete shoqeri.

Ajo vendos per:

- 1- Bilancin vjetor.
- 2- Ndryshimet ne statut.
- 3- Shtimin dhe pakesimin e kapitalit themeltar.
- 4- Emerime dhe shkarkime te administratorit.
- 5- Emerimin e ekspertit kontabel.
- 6- Hapjen e degeve, filialeve apo perfaqesive te saj.
- 7- Shnderrimin e shoqerise ne një forme tjeter te saj.
- 8- Zgjatja e afatit te aktivitetit te saj.
- 9- Vendime per marrjen pjesë ne shoqeri te tjera.
- 10- Ndryshimi I vendgendrimit te selise.
- 11- Aprovimin e rregullores se shoqerise dhe te gjitha kopetencat e tjera te parashikuar ne legjislacionin perkates.

#### Neni 9

Mbledhja e zakonshme e Asamblese se Ortakeve realizohet me lajmerimin qe u drejtohet nga administratori ose eksperti kontabel 15 dite perpara duke percaktuar edhe rendin e dites. Vendimet e marraa nga Asamblea e Ortakeve ne mbledhjet e zakonshme dhe te jashtezakonshme, ne perputhje me kete statut jane te detyrueshme dhe te zbatueshme per te gjithe. Mbledhja e Asamblese se Ortakeve behet te pakten nje here ne vit.


#### Neni 10

Cdo ortak ka te drejte te marre pjesë ne aktivitetin e Shoqerise ne menyren e percaktuar ne Akt - Themelimin dhe ne Statutin e shoqerise, te marre një pjesë te fitimeve te aktivitetit te shoqerise, te marre informacion mbi aktivitetin e Shoqerise pa asnje pengese. Ka te drejte te beje konbtrollin e librave te Shoqerise me ane te nje kontrolli te specializuar. Ortaket kane te drejte qe te transferojne lirishjt jashte shtetit ne valuten qe deshirojne, ate pjesë fitimi qe ju takon. Po keshtu edhe kundravleren e kuotave te kapitalit qe mund te shese, apo vleften qe i perket asaj ne rast se shoqeria do te likujdohet.

#### ADMINISTRATORI

#### Neni 11

Administrator i Pergjithshem i Shoqerise eshte z. Lulzim Kapllanaj.



Administratori kryen veprime ne emer dhe per llogari te shoqerise. Ne marredhenie me te tretet Administratori I Pergjithshem ka te gjitha kopetencat per te kryer veprime ne interes dhe per llogari te shoqerise dhe qe jane ne perputhje me objketin e Shoqerise.

Administratori i shoqerise eshte I detyruar te punoje, drejtoje dhe organizoje shoqerine ne menyre qe te siguroje suksesin ekonomiko - finanziar te veprimtarise se shoqerise. Te zbatoje vendimet qe merr Asamblea e Ortakeve ne kuader te kopetencave qe I cakton ky statut ose ne baze te legjislacionit ne fuqi.

Administratori nuk ka te drejte te kerkoje dhe terhqe kredi bankare, pa pelqimin me shkrim te dy ortakeve themelues.

#### MARREDHENIET EKONOMIKO FINANCIARE

##### Neni 12

##### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE DHE REZERA E DOMOSDOSHME

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar te cdo viti dhe perfundon me 31 Dhjetor, me perjashtim te vitit te pare, ku si fillim eshte data e rregjistrimit te shoqerise.

##### Neni 14

Llogarite vjetore, inventaret, raportet, mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga Asamblea e Ortakeve dhe eventualisht nga eksperti kontabel I autoriazuar miratohen nga Asamblea e Ortakeve. Miratimi I bilanceve mbi veprimtarine vjetore behet brenda muajit Mars te viti pasardhes.

##### Neni 15

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te fitimit, Asamblea e Ortakeve percakton pjesen e fitimit qe I takon, pasi te jene zbritue shumat e lena menjane per fondin rezevre te domosdodhem, ajo pjese qe mbetet nga fitimi pasi te jete zbritur pjesa qe do te kaloje ne fondin rezevre, pjesa per fondu e tjera eventuale dhe pasi te jene likujduar te gjitha detyrimet tatimore, ju perket ortakeve te cilet kane te drejte ta disponojne teresisht.

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se sigurimeve shoqerore, etj.

Ajo ka te drejte te celi llogari likujduese prane bankave te vendit dhe te kryeje veprime likujdimi ne to.

**Neni 16**

**MARREDHENIET E PUNESIMIT DHE LIDHJA E KONTRATAVE**

Marredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen nepermjet kontrates se punesimit, qe lidhet midis paleve ne perputhje me Kodin e Punës dhe legjislacionin shqiptar te punesimit.

**Neni 17**

Marria ne pune behet me rregjistrimin nga punedhenesi ne librin e punës se Shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e punës te juridikcionit ku ushtron veprimtarine shoqeria.

**Neni 18**

Largimi nga puna behet me mbarimin e kontrates se punës, per shkelje disiplinore, ose me vete kerkesen e te interesuarit.

Largimi nga shoqeria behet pasi jane shlyer te gjitha detyrimet materiale dhe monetare.

**Neni 19**

Kontrolli I Shoqerise kryhet nga eksperti kontabel I autorizuar. Shkrkimi I ekspertit kontabel te autorizuar vendoset me te njejtat kushte si emerimi, ne rast se verehen gabime ne punen e tij gje qe e ben te pamundur kryerjen e detyres.

**ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI**

**Neni 20**

Me mbarimin e afatit te percaktuar ne aktin e themelimit, zgjatja e tij behet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve. Ajo prishet kur mbaron afati I percaktuar nga ortaket dhe keta nuk kane rene dakord qe te bejne riparteritjen e ketij afati.

**Neni 21**

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e vendosjes per prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi emerohen nje ose disa likujdatore te cilet ndjekin operacionet e likujdimit deri ne fund dhe I

paragesin Asamblese se Ortakeve rezultatet perfundimtare te likujdimit. Ne perfundim te procesit te likujdimit Asamblea e Ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar, mbi aktin dhe rregullsine e likjdimit, mbi mbylljen e procesit te likujdimit te shoqerise.

**Neni 22**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindingjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te kalojne ne kompetence te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

C eshtjet e tjera qe nuk jane trajtuar ne kete statut I referohen legjislacionit tregtar shqiptar.

**Neni 25**

Ky statut eshte perpiluar dhe firmosur ne kater kopje me vlore te njejte me origjinalin.


Tirane me 03.06.2005

**SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
" HYDROPOWER"

**ORTAKET**

**LULZIM KAPLLANAJ**

**CHRISTIANA TSOUKATOS**

   
Lulzim Kapllanaj, Tsoukatos Christiana

Perlthyes/  
Lulzim Kapllanaj  
